



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

24146
Nr. _____ prot.

Shkodër, më 21.11.2025

**PROJEKTVENDIM
PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARES
BASHKIAKE ZNJ. BLEDIANË NIKA**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të radhës, në mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronja “b”, pika 5, nenit 54, shkronja “j”, nenit 55, pika 3 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, nenit 19, pika 1, shkronja, “b” të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, si dhe pas shqyrtimit të shkresës nr. 23964 prot., datë 20.11.2025 “Kërkesë për dorëheqje” dhe relacionit nr. 24091 prot., datë 21.11.2025 të Komisionit të Mandateve,

VENDOSI :

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Shkodër, Znj. Bledianë Nika, për shkak të dhënies së dorëheqjes nga ana e saj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretaria e Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 24091 prot.

Shkodër, më 21.11. 2025

Lënda: *Relacion*

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Komisioni i mandateve të Këshillit Bashkiak Shkodër, sot në datën 21.11.2025, mori në shqyrtim rrethanat e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake, përfaqësuese e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë znj. Bledianë Nika, për shkak të dorëheqjes së saj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi:

KQZ me vendimin nr.633, datë 26.5.2023 "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", ndër të tjera ka shpallur fituese, nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor PS, znj. Bledianë Nika.

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të parë të datës 19.6.2023, me vendimin nr.2, datë 19.6.2023, ka miratuar mandatin e znj. Bledianë Nika në cilësinë e anëtares së Këshillit Bashkiak.

Këshilltarja e mandatur znj. Bledianë Nika, kandidate e listës shumëemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr.23964 prot., datë 20.11.2025, ka dhënë dorëheqjen nga mandati i këshilltares bashkiake, Bashkia Shkodër.

Në këto kushte mbështetur në nenin 49, pika 4, gërmat "b" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 19 pika 1, gërma "b" e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Shkodër", komisioni i mandateve duke vlerësuar të rregullt dokumentacionin e shqyrtuar, i propozon këshillit bashkiak, marrjen e vendimit përkatës për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake znj. Bledianë Nika.

KOMISIONI

SEKRETAR

KRYETAR

ANËTAR

Izmira RUSI

Uarda GJEKAJ

Gjovalin NDÏJ

m/23864 pot
20.11.2025

Shkoder me 20.11.2025

Lënda : Kërkesë për dorëheqje nga mandati 2023-2027 i këshilltares së Këshillit Bashkiak Shkodër, përfaqësuese e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Kryetarit

Sekretarit

Komisionit të Mandateve

Të nderuar!

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, në mbështetje të nenit 49, pika 4b, për arsye familjare deklaroj se jap dorëheqjen time nga mandati 2023-2027 i këshilltares së këshillit të bashkisë Shkodër, përfaqësuese e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Duke shprehur në mirëkuptimin tuaj ,ju falenderoj për bashkëpunimin.

Me respekt

Bledianë Nika (OSJA)

